

**STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“EL TECHALBANIA GROUP” Sh.P.K

Ky statut perpilohet nga:

Faik Hasani, i biri i Hasanit, shtetas i Republikes se Kosoves, i datelindjes 01/05/1980, lindur ne Skenderaj, dhe banues ne Kosove me adrese banimi Kline e Poshtme, Skenderaj, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i pajisur me Karte Identiteti me numer personal 1021299142 dhe pashaporte me numer P02263636.

Te quajtur me poshte ortake themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, si vijon:

KREU I

**NENI 1
FORMA**

Ortaket e mesiperm krijojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2
EMRI I SHOQERISE**

Emri i shoqerise do te jete **“EL TECHALBANIA GROUP” Sh.P.K**

**NENI 3
SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria do te kete qendren e veprimtarise se saj ne rrethin e Tiranes me adrese te selise: Njesia Bashkiake Nr.7, Rruga Muhamet Gjolllesha, Pallati Zaimaj, Shkalla 2, Kati 1, Tirane. Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.



NENI 4 KOHEZGJATJA

Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te kete per objekt te veprimtarise se saj:

- 1.Ndertimi i projekteve te tubacioneve dhe kanalizimeve.
- 2.Ndertimi i projekteve te sherbimeve publike per energji elektrike dhe telekomunikime.
- 3.Ndertimi i projekteve te ujit.
- 4.Ndertimi i projekteve te tjera te ndertimit civil p.k.t.
- 5.Demolimi i objekteve
- 6.Pergatitja e vendpunishtes.
- 7.Instalime elektrike.
- 8.Punime hidraulike, instalime te ngrohjes dhe kondicionimit te ajrit.
9. Tregtia me shumice e metaleve dhe mineraleve.
- 10.Pastrimi i pergjithshem I ndertesave.

KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

NENI 6

Kapitali themeltar shoqerise eshte 100,000 (njqind mije) Leke i ndare ne 1 kuote me vlere 100.000 leke per nje kuote.

NENI 7

KONTRIBUTET

Kontributi percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti i takon ortakeve themelues ne masen:

Faik Hasani 1 Kuote (100.000 leke)



NENI 8

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen:

Faik Hasani 100%

NENI 9

TRANSFERIMI 1 PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit themeltar te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekjeje.

Ne rast se njeri nga ortaket deshiron te transferoje nje pjese apo te gjithe kuotat qe ai zoteron ne shoqeri duhet ti drejtohet me nje kerkese ortakut tjetër, me ane te se ciles ti bej te ditur sasine e kuotave, cmimin dhe personin te cilit do tia transferoje. Ortaku tjetër eshte i detyruar qe brenda nje afati nje mujor ti ktheje pergjigje nese deshiron ti bleje kuotat me te njetat kushte apo jo. Ne rast se brenda afatit ortaku nuk kthen pergjigje atehere tranferimi konsiderohet si i miratuar dhe ortaku eshte i lire te kryej transferimin sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 10

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit.

NENI 11

DREJTIMI SHOQERISE



Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mblidhet si rregull dy here ne vit, si dhe sa here qe gjykohet e arsyeshme. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.

NENI 12

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve vendos per keto ceshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos per shperndarjen e dividendit te shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
- Si dhe per cdo ceshtje qe gjykon te arsyeshme
- Vendimet e asamblese nenshkruhen nga ortaket

NENI 13

ADMINISTRATORI

Administratore e shoqerise do te jete **znj. Gjystina Kopshtari**, shtetase shqiptare, e pajisur me pashaporte me numer BD2833381 dhe numer personal G36126063N, per nje afat 5 (Pese) vjecar.

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqerise emerohet nga asambleja e ortakeve te cilet pergjigjen per zbatimin e vendimeve te asamblese se ortakeve

Administratoret kane keto kompetenca :

- Te bejne drejtimin e shoqerise .



- Te perpilojne dhe nenshkruajne kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise;
- Te hapin llogari rrjedhese bankare prane bankave shqiptare ose te huaja.
- Te perfaqesojne shoqerine ne mardhenie me te tretet.
- Te emerojne nenpunes te rangjeve te ndryshme per veprime te vecanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh;
- Te bejne gjithçka tjeter qe konsiderojne te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti e te Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

KREUI V
LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE
LIKUJDIMI

NENI 15

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacinit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

- 1- Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Admimstratoreve.
- 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

NENI 16

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2023. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operationet e vecanta te hartuara nga admimstratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

KREU V

NENI 17

AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim Bilancit i bashkengjiten:

- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,



b. Nje situacion sibi sigurimet e bera nga shoqeria.

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne diten qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

NENI 18

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me ligjin nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

NENI 19

PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese Ortakeve.

NENI 20

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit.

NENI 21

Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

NENI 22

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

NENI 23

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e Ortakeve .

NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve. Mjetet fnanciare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

NENI 25

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit. Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 26

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakeve themelues.



THEMELUESI

Faik Hasani

FAIK HASAWI

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized letters that appear to be 'FAIK' followed by a flourish.

06 / 10 / 2023